



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:143556
Datë: 29.06.2024
Numri i dokumentit: 05876610

CAP.nr.1375/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores International Maarif Schools of Kosova sh.p.k., me seli në Prizren, rr. “....” pn., me NUI ,..... të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.K., avokat në Prishtinë, kundër debitorit F.G. nga Prizreni, rr. “....” nr..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh.E., avokat në Prizren, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të kreditores, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.73/23, datë 13.09.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditores International Maarif Schools of Kosova sh.p.k., me seli në Prizren, rr. “.... pn., me NUI.... , ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.73/23, i datës 13.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.73/23 të datës 13.09.2023, ka vendosur që të aprovet si i bazuar prapësimi i debitorit F.G. nga Prizreni, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.186/2023, i lejuar me datë 30.05.2023, nga Përmbartuesi Privat E.H. me seli në Prizren, Anulohet.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i kreditores brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paraqitur nga kreditorja dhe të lejohet përmbartimi ashtu që debitori të ekzekutoj pagesën në shumë prej 1,281.85 € me anë të përmbartimit të dhunshëm në afat prej 3 ditësh, ose lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se

Ankesa e kreditores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr. PZ.... e datës 15.08.2019 ka paraqitur propozim për përmbartim me datë 30.05.2023, ndaj debitorit për shumën e detyrimit në lartësi prej 1,281.85 € si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditores të datës 30.05.2023, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor me shenjë P.nr.186/2023 datë 30.05.2023, me të cilën e ka lejuar përmbartimin sipas faturës nr. datë 15.08.2019, duke e pranuar si dokument të besueshëm, i cili i plotëson kushtet për të lejuar përmbartimin.

Kundër Urdhrit përmbartimor i autorizuari i debitorit ka paraqitur prapësim me datën 16.06.2023, duke propozuar që gjykata ta anulojë urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat dhe propozimin për përmbartim të kreditores ta refuzoj si të pabazuar.

Me përgjigje në prapësim të datës 27.06.2023, i autorizuari i kreditores ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor, të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor dhe rrjedhimisht të lejohet përmbartimi sipas propozimit për përmbartim të kreditores dhe detyrohet debitori që kreditores t'ia shpërblej shpenzimet për iniciimin e procedurës përmbartimore në shumën prej 100.30€.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 73/23, i datës 13.09.2023, ka vendos që ta pranoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e anuluar Urdhrin Përmbartimor, P.nr.186/2023, të datës 30.05.2023, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka parashtruar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkak se si në vijim Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, thuhet se, "Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm", ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton se fatura është dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në anën tjetër paragrafi 3, i nenit 29 të LPP-së, përcakton se "Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumta dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar". Tutje, sipas nenit 37 të LPP-

së thuhet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”. Në mbështetje të dispozitave si më lartë, gjykata gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarrimor nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret, nuk mund të vërtetohet që të njëjtat fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat i janë dorëzuar debitorit, pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe pranuar nga debitori. Rrjedhimisht, si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e kreditorit se, detyrimi dhe faturat burojnë nga kontrata e regjistrimit të nxënësit, të cilën kontratë ia ka bashkëngjitur propozimit për përmbarrim, mirëpo kjo kontratë nuk paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, andaj e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i kësaj procedure. Gjykata rikujton se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Gjithsesi, kjo vendosje nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që për realizimin e kërkesave eventuale në raport me debitorin, të zhvilloj kontest të rregullt civil, pranë gjykatës kompetente. Nga arsyet e paraqitura, gjykata duke vlerësuar se në rastin konkret dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 3, 21, 29 paragraf 1, pika 1.3 dhe paragraf 3,71 paragraf 1.1 dhe 73 paragraf 3 të LPP-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës përmbarrimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarrimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është i qartë si në pjesën e dispozitivit dhe atë të arsyetimit dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë edhe arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe fakteve vendimtare. Një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktvendimi i atakuar përmban të gjitha elementet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 160 e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast nuk kanë qenë të plotësuara kushte ligjore për lejimin e përmbarrimit, për faktin se kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës ka konstatuar dhe vërtetuar se fatura në bazë të të cilës është lejuar përmbarrimi, nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 paragraf 3, 30 dhe 38 të LPP-së, për lejimin e përmbarrimit, ngase e njëjta rezulton të mos jetë nënshkruar dhe pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori.

Me nenin 29 paragraf 1 pika 1.3 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në to holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është ... Fatura”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si prova materiale

gjenden fatura nr. ... e datës 15.08.2019, e që në çështjen konkrete gjykata e shkallës së parë në rastin e vendosjes me aktvendimin e atakuar ka konstatuar se e njëjta nuk ka qenë e nënshkruar nga debitori, pasi që nuk është vërtetuar se fatura i është dorëzuar debitorit.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të prapësimit të palës debitore të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, P.nr. 186/2023 i datës 30.05.2023, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit, e nga shqyrtimi i shkresave të lëndës shihet qartë se fatura siç është prezantuar në këtë rast nuk ka cilësinë e dokumentit të besueshëm, ashtu siç parashihet me nenin 29, 30, 37 dhe 38 të LPP-së.

Në këtë rast organi përmbarues - Përmbaruesi privat, para se të nxjerr urdhrin përmbarimor, ka pasur për detyrim ligjor që të vlerësoj se propozimi për përmbarim i paraqitur nga kreditorja a përmbaruesi të dhënat e mjaftueshme, të cilat kërkojnë me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së, dhe në rast se propozimi për përmbarim nuk ka përmbarues të gjitha të dhënat e nevojshme, atëherë nuk ka pasur pengesa ligjore që konform nenit 17 dhe 38 paragrafi 2 të LPP-së, lidhur me nenin 102 paragraf 1 të LPK-së, të ftoj kreditoren që brenda afatit kohor ligjor të bëjnë plotësimin, rregullimin dhe precizimin e propozimit për përmbarim, duke e njoftuar qartë kreditoren edhe për lëshimet procedurale në rast mosveprimi sipas urdhrin të organit përmbarues, brenda afatit kohor ligjor të dhënë, që pastaj varësisht prej veprimeve apo mosveprimeve nga ana e kreditorit, organi përmbarues të kishte mundësi që të ndërmerre hapat tjerë procedural të paraparë me ligj, mirëpo ky detyrim në këtë rast, nuk ka qenë detyrimi i gjykatës sepse në këtë rast organi përmbarues, është përmbaruesi privat e jo gjykata, gjykata do të kishte një detyrim të tillë sikur të ishte organ përmbarues.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr. 1375/23, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli,